

VENDIM
Nr. 344, datë 24.4.2013

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 180, DATË 13.2.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË MAKINERIVE E TË PAJISJEVE QË
JANË DREJTPËRDREJT TË LIDHURA ME INVESTIMIN DHE TË PROCEDURAVE TË
PËRJASHTIMEVE E TË KRITEREVE PËRKATËSE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “g”, “gj” e “i” të nenit 261/1 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 180, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave, të shtohen, sipas rendit të tabelës, kodet tarifore, si më poshtë vijon:

- 8410 11 00 - Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që nuk i kalon 1 000 kW;
- 8410 12 00 - Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që i kalon 1 000 kW, por nuk i kalon 10 000 kW;
- 8410 13 00 – Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që i kalon 10 000 kW;
- 8410 90 00 – Pjesët, përfshirë rregullatorët;
- 9022 19 00 – Skanerët me rreze X (përveç atyre të përdorur në mjekësi, kirurgji, stomatologji dhe veterinar);
- 9406 00 31 – Serrat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha